

Udhëzim për udhëheqjen e Evidencës pedagogjike për aktivitetet jashtëmësimore

Për të zhvilluar interesa të ndryshme të nxënësve, sipas nenit 41 të Ligjit për arsimin fillor, shkolla fillore organizon aktivitetet jashtëmësimore në përputhje me Konceptin për aktivitetet jashtëmësimore, i cili me propozim të Byrosë së Zhvillimit të Arsimit përcaktohet nga ministri i Arsimit dhe Shkencës. Nxënësit në aktivitetet jashtëmësimore përfshihen vullnetarisht.

Aktivitetet jashtëmësimore të cilat i realizon shkolla fillore përcaktohen nga programi vjetor i punës së shkollës.

Evidencia pedagogjike për aktivitetet jashtëmësimore, si formular për dokumentacionin dhe evidencën pedagogjike në shkollat fillore është vendosur në ueb faqen e Byrosë së Zhvillimit të Arsimit (www.bro.gov.mk), Veprimtaria botuese, Dokumentacioni dhe evidencia pedagogjike) si dokument në word. Mësimdhënësi klasor ose lëndor **Evidencën pedagogjike për aktivitetet jashtëmësimore** (formulari numër 15) e udhëheq në mënyrë elektronike gjatë gjithë vitit shkollor.

Mësimdhënësi fillimisht plotëson faqen ballinë në formularin **Evidencia pedagogjike për aktivitetet jashtëmësimore** (shkruan emrin e shkollës fillore, vendin dhe komunën në të cilën ndodhet shkolla, vitin shkollor për të cilin mbahet **Evidencia pedagogjike për aktivitetet jashtëmësimore**, shënon emrin dhe mbiemrin e tij dhe shkruan datën kur filloi të plotësojë dokumentin. Në faqen 1 mësimdhënësi e shënon periudhën kohore gjatë vitit shkollor në të cilin duhet të realizohet aktiviteti jashtëmësimor, dita / ditët e planifikuara në javë, si dhe kohën gjatë ditës kur duhet të realizohet aktiviteti jashtëmësimor.

Në kuadër *Të dhënatur elementare për aktivitetin jashtëmësimor* mësimdhënësi e shkruan aktivitetin jashtëmësimor; numrin e planifikuar të nxënësve dhe nga cilat paralele janë ata nxënës që do të marrin pjesë në aktivitetin jashtëmësimor; qëllimin e realizimit; mënyrën e realizimit; mënyrën e vlerësimit; mënyrën e përdorimit të rezultateve si dhe mjetet / burimet e nevojshme për realizimin e aktivitetit jashtëmësimor.

Në pjesën *Plani vjetor dhe programi i aktiviteteve jashtëmësimore* në kolonën, numri rendor shënohet me 1, numri i aktivitetit të parë jashtëmësimor (nëse

mësimdhënësi planifikon të realizojë disa aktivitete jashtëmësimore gjatë vitit shkollor). Nën numrat rendorë 2, 3... shënohen të dhënat për aktivitetet e dyta, të treta ... jashtëmësimore që janë planifikuar deri në fund të vitit shkollor. Në kolonën e dytë shënohen përmbajtja konkrete e aktivitetit jashtëmësimor (e përgjithshme), në kolonën tjeter shkruhet numri i orëve të planifikuara për të realizuar atë përmbajtje, dhe në kolonën e fundit shënohet emri e mbiemri i mësimdhënësve të tjerë ose profesionistëve të tjerë të cilët janë planifikuar të angazhohen në realizimin e aktivitetit jashtëmësimor (nëse mësimdhënësi realizon vetë aktivitetin jashtëmësimor, kjo kolonë nuk plotësohet).

Në kuadër të *Evidenca e orëve të realizuara të aktivitetit jashtëmësimor* shënohen: numri rendor i aktivitetit konkret, data e realizimit, përmbajtja konkrete e aktivitetit, emri e mbiemri i realizatorit/realizatorëve të aktivitetit konkret dhe një shënim (aktiviteti konkret i mbajtur, nëse nuk është mbajtur cilat janë arsyet e mosmbajtjes, nëse është ristrukturuar, për cilën datë është rishikuar, etj.). Evidenca plotësohet pas realizimit të aktivitetit konkret.

Në pjesën *Lista e nxënësve të përfshirë në aktivitete jashtëmësimore dhe pasqyra e rregullsisë së tyre*, shënohet numri rendor i nxënësit/nxënëses, emri e mbiemri i nxënësit/nxënëses, i cili/e cila duhet të përfshihet në aktivitetin konkret jashtëmësimor, në cilën paralelë është regjistruar ai/ajo, nxënës/nxënëse, në cilën datë nuk ka qenë i pranishëm/e pranishme /nxënësi/nxënësja dhe gjithsej sa mungesa ka secili nxënës/nxënëse në fund të aktivitetit jashtëmësimor.

Në pjesën Monitorimi dhe vlerësimi i pjesëmarrjes, angazhimit dhe përparimit të niveleve të arritjeve të nxënësit/nxënëses në aktivitetin jashtëmësimor shënohen në fund të aktivitetit jashtëmësimor, këto të dhëna: i njëjtë numër rendor i nxënësit/nxënëses nga pjesa Lista e nxënësve të përfshirë në aktivitete jashtëmësimore dhe një rishikim të rregullsisë së tyre; emrin e mbiemrin e nxënësit/nxënëses, i cili/e cila ishte përfshirë në aktivitetin konkret jashtëmësimor; në cilën paralelë është regjistruar ai nxënës/ajonnxënëse; komponentët sipas të cilëve mësimdhënësi i monitoroi dhe përcaktoi arritjet e seilit nxënës/nxënëse (përveç komponentëve të futur në formularin, mësimdhënësi i shënon edhe komponentët tjerë të monitorimit dhe arritjeve nëse i ka përdorur); niveli konkret i arritjeve të nxënësit/nxënëses (sipas komponentëve të monitorimit dhe arritjeve) shënuar si I ose II ose III (III është niveli më i lartë i arritjeve; në kolonën SHËNIME mësimdhënësi i shënon rezultatet më të rëndësishme të arritura nga nxënësi/nxënësja, rekomandimet dhe vëzhgimet e tjera për nxënësin/nxënësen në lidhje

me aktivitetin jashtëmësimor në të cilën kanë marrë pjesë (në fund të realizimit të aktivitetit jashtëmësimor).

Mësimdhënësi në formularin e dokumentacionit pedagogjik Dëftesë shtesë për nxënësin/nxënësen i/ e përfshirë në aktivitetin jashtëmësimor shënon nivelin e arritjeve të atij nxënësi, asaj nxënëse dhe tërë tekstin e shkruar në kolonën SHËNIME nga Evidenca Pedagogjike për aktivitetet jashtëmësimore. Ju përkujtojmë se në fund të këtij viti shkollor 2020/2021, nuk do të lëshohet Dëftesa shtesë.

Pjesa *Analiza e suksesit të aktiviteteve jashtëmësimore* plotësohet në fund të vitit shkollor, ku për secilin aktivitet jashtëmësimor të realizuar shënohet në përgjithësi: cilat janë konkluzionet, sa me sukses janë realizuar qëllimet e përcaktuara, si dhe propozimet e mundshme për përmirësimin e planifikimit dhe realizimit të aktivitetit jashtëmësimor. Teksti nga *Analiza e suksesit të aktiviteteve jashtëmësimore* dhe nga Të dhënat statistikore për aktivitetin jashtëmësimor (gjithsej sa nxënës morën pjesë në çdo aktivitet jashtëmësimor, çka është realizuar nga Plani vjetor dhe programi i aktivitetit jashtëmësimor dhe çka nuk është realizuar) do të përdoret për përpilimin e Raportit vjetor për punën konkrete të shkollës filllore.

Evidenca pedagogjike për aktivitetin jashtëmësimor të udhëhiqur në mënyrë elektronike nga mësimdhënësi klasor ose lëndor gjatë vitit shkollor, në fund të vitit shtypet, kopja në letër regjistrohet me një numër arkivi dhe mësimdhënësi ia dorëzon drejtorit të shkollës filllore. Numri i arkivit nën të cilin certifikohet dokumenti **Evidenca pedagogjike për aktivitetin jashtëmësimor** shënohen në **Ditarin e paraleles**, pjesa Evidenca e aktiviteteve jashtëmësimore, nëse nxënësit nga paralelja konkrete morën pjesë në aktivitetin konkret jashtëmësimor.

SHTOJCA 1

Shembull për plotësimin e tabelës: TË DHËNA ELEMENTARE PËR AKTIVITETIN JASHTËMËSIMOR

Aktiviteti jashtëmësimor	Klubi i dramës-skenës
Numri i planifikuar i nxënësve dhe nga cila paralele	10 nxënës nga paralele të ndryshme
Qëllimet	<p>Edukimi i interesit për shprehjen dramatike në skenë.</p> <p>Inkurajimi dhe zhvillimi i fjalimit të duhur të nxënësve.</p> <p>Zhvillimi i komunikimit të dyanshëm (aktor-regjisori).</p> <p>Zhvillimi i përvjës emocionale dhe estetike të nxënësit/nxënëses në botë.</p> <p>Edukimi i qëndrimit ndaj punës në ekip.</p> <p>Inkurajimi i nxënësve për shprehje krijuese dhe hartimi i një procesi krijues.</p>
Mënyra e realizimit	<p>Zbatimi i metodës së shpjegimit, puna me tekstin.</p> <p>Ndjekja e shfaqjeve teatrale.</p> <p>Bisedë me aktorë, regjisori.</p> <p>Performancë në shkollë për nevojat e vetë shkollës.</p> <p>Shfaqje në takime ndërshkollore, komunale, rajonale dhe shtetërore, etj.</p>
Mënyra e vlerësimit	Sukses i arritur në ndeshjet dhe plasmani i ndeshjeve.
Mënyra e përdorimit të rezultateve	<p>Shpërblimi i nxënësve për rezultatet e arritura (me notë, mirënjojje).</p> <p>Edukimi i shprehjes së folur dhe dramatike, promovimi i shkollës, performimi i shfaqjeve shkollore.</p>
Mjetet e nevojshme	Mjetet për udhëtime në shfaqje jashtë vendbanimit. Mjetet, fonet do të sigurohen nga buxheti i komunës.

SHTOJCA 2

Shembull për plotësimin e tabelës: TË DHËNA ELEMENTARE PËR AKTIVITETIN JASHTËMËSIMOR

Aktiviteti jashtëmësimor	Sekzioni i gjeografisë
Numri i planifikuar i nxënësve dhe nga cila paralele	15 nxënës nga paralele të ndryshme
Qëllimet	<p>Kënaqësia e interesit të nxënësve për zgjerimin dhe thellimin e njohurive të tyre në fushën e gjeografisë.</p> <p>Kuptimi i koncepteve themelore gjeografike dhe marrja e njohurive dhe aftësive shtesë gjeografike.</p> <p>Zhvillimi i njohurive hartografike, digitale, statistikore, matematikore dhe aftësive të tjera të nevojshme për të përvetësuar njohuri dhe aftësi praktike gjeografike.</p> <p>Zotërimi i aftësive gjeografike në korrelacion me lëndët përkatëse.</p>
Mënyra e realizimit	<p>Studimi i literaturës shtesë.</p> <p>Leximi i teksteve dhe hartave profesionale.</p> <p>Zbatimi i metodës së shpjegimit, puna me tekst, zgjidhja e testeve dhe analizimi i zgjidhjeve.</p> <p>Zhvillimi i projekteve individuale dhe grupeve.</p> <p>Zbatimi i të mësuarit në bashkëpunim, si dhe i metodave aktive të mësimdhënies dhe mësimnxënies (p.sh. metoda e zgjidhjes së problemeve).</p> <p>Do të përdoret forma e punës në grupe të vogla, në çifte dhe punë individuale.</p>
Mënyra e vlerësimit	Shpërblimi i nxënësve për rezultatet e arritura (me notë, mirënjojje).
Mënyra e përdorimit të rezultateve	Analizë e rezultateve të arritura në mënyrë që të përmirësohet cilësia e

	mësimdhëties. Rezultatet e vlerësimit të suksesit të seksionit të gjeografisë do të përdoren si element në vlerësimin e rezultateve në lëndën specifike, si dhe në vlerësimin e përgjithshëm të arritjeve të shkollës fillore.
Mjetet/resurset e nevojshme	/